



Hedhja në kosh e ligjit për qeset plastike

RAPORT MONITORIMI

Gusht-Tetor 2022



AUTOR
ORJANA ÇEKREZI

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al



Tabela e permbajtjes

Plastika dhe dëmet që shkakton në mjedis	3
Kuadri ligjor në Shqipëri dhe institucionet përgjegjëse	3
Perceptimi i qytetareve mbi zbatueshmërinë e ligjit për ndalimin e përdorimit të qeseve plastike një përdorimshe	6
Fushata sensibilizuese lidhur me ligjin	7
Gjetjet kryesore	8
Rekomandime.....	9

Plastika dhe dëmet që shkakton në mjedis

Plastika si material i plotë sintetik u krijua për herë të parë në vitin 1907 dhe qysh prej atëherë do të luante një rol tejet të rëndësishëm në industri dhe në çdo fushë për kryerjen e funksioneve të ndryshme si për të prodhuar ambalazhe, materiale në ndërtim, tekstile, produkte të konsumit, makineri elektrike, elektronike dhe industriale. Për vite me rradhë njerëzimi ka shfrytëzuar në maksimum lëndën e plastikë, pa menduar për pasojat ekologjike dhe shëndetësore që ajo mund të sjellë.

Sipas Global Change Data Lab¹, në vitin 1950, bota prodhonte vetëm 2 milionë tonë plastikë në vit. Që atëherë, prodhimi vjetor është rritur gati 230 herë, duke arritur në 460 milionë tonë në 2019. Ndërkohë nga 5800 milionë tonë plastikë parësore që nuk përdoren më, vetëm 9 për qind është ricikluar që nga viti 1950.

Sa i përket Shqipërisë, e cila njihet si një nga vendet që kontribuon më së shumti në ndotjen e oqeanëve në botë, rezulton se vetëm për vitin 2019, janë emëtuar mesatarisht 0.54 kg plastikë për person. Ndërkohë që mbetjet plastike të keqmenaxhuara për frymë në Shqipëri, në 2019, janë 24.24 kg për person, një shifër kjo, tejet alarmante.

Duke konsideruar dëmet që plastika ka shkaktuar në të gjithë botën, shumë qeveri kanë ndërmarrë masa të ndryshme për parandalimin e përdorimit të saj.

Duke kuptuar dëmin që po shkaktonte plastika, në vitin 2002, Bangladeshi bëhet vendi i parë në botë që zbaton një ndalim për qeset e hollë plastike, pasi u zbulua se ato luajtën një rol kyç në bllokimin e sistemeve të kullimit gjatë përmbytjeve. Më pas, vendet e tjera fillojnë e disa prej tyre tentojnë të ndjekin shembullin e tij.

Kuadri ligjor në Shqipëri dhe institucionet përgjegjëse

Për të ndjekur modelet e tjera në botë dhe me aspirata të larta, Shqipëria nis diskutimet në vitin 2019, për tu bërë i pari vend në Europë për largimin e qeseve plastike nga përdorimi, që nxiti fushatën "Shqipëria vendi i parë Evropian pa qese plastike" me në krye ish-ministrin e turizmit dhe mjedisit, Blendi Klosi.²

¹ [Mbetjet plastike dhe ndotja, "Mbetjet plastike të emetuara në oqean për frymë, 2019"- Our World in Data](#)

² [Ligji për ndalimin e qeseve plastike hyn në fuqi, por sërish nuk gjen zbatim- Porta Vendore](#)

Kjo nismë nuk gjeti zbatim dhe vetëm pas 3 vitesh, më 17 mars 2022, Kuvendi miratoi ndalimin e përdorimit të qeseve plastike në Shqipëri. Sipas këtij vendimi³, u përcaktuan masa të hollësishme për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimit, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, me trashësi të mureve të qeses për çdo anë më të vogël se 70 (shtatëdhjetë) mikronë, me kapacitet mbajtës më të vogël se 10 (dhjetë) kilogramë dhe me përmasa më të vogla se 50 (pesëdhjetë) cm gjatësia dhe 24 (njëzetë e katër) cm gjerësia, pa përfshirë gjerësinë e palosjeve, si dhe të qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme, nga subjektet, sipas parashikimeve të këtij vendimi, nga data 1 qershor 2022.

Sipas këtij ligji çdo person apo subjekt, që angazhohet në menaxhimin e mbetjeve të ambalazheve të ndryshme nga ato të përcaktuara në nenin 29 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë.

Sakaq, çdo person apo subjekt që hedh në treg, prodhon, importon ose fut në territorin e Republikës së Shqipërisë qese plastike mbajtëse, si dhe qese plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo të oxo-biodegradueshme, sipas përcaktimit të pikës 3 të nenit 29 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën 500 000 (pesëqind mijë) lekë dhe sekuestrimin e qeseve plastike të ndaluara.

Kur personi apo subjekti, i cili është dënuar me gjobë në vlerën 500 000 (pesëqind mijë) lekë dhe sekuestrimin e qeseve plastike të ndaluara konstatohet se hedh në treg, prodhon, importon ose fut në territorin e Republikës së Shqipërisë qese plastike mbajtëse, si dhe qese plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo të oxo-biodegradueshme, dënohet me gjobë në vlerën 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) lekë dhe sekuestrimin e qeseve plastike të ndaluara.

Kur personi i cili është dënuar me gjobë në vlerën 1 500 000 (një milion e pesëqind mijë) e shkel përsëri këtë ligj, atëherë dënohet me revokimin e lejes/licencës së prodhimit dhe sekuestrimin e qeseve plastike të ndaluara.

Sipas këtij ligji, subjektet që prodhojnë, importojnë apo hedhin në treg qese njëpërdorimshme, të ndaluara, dënohen më një gjobë prej 500 mijë lekë (të reja) deri në 1 milion e 500 mijë lekë (të reja). Në rast përsëritje të shkeljes së këtij ligji, dënohen me 15 milionë lekë, deri në heqje licence biznesit.

³ [Ligji për menaxhimin e integruar të mbetjeve](#)

Për zbatimin e këtij vendimi janë ngarkuar Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave (DPD).

ISHMT është insitucioni i ngarkuar që kryesisht ka në përgjegjësi mbikëqyrjen dhe kontrollin nëpërmjet kontrollit dokumentar fizik, inspektim për verifikimin e plotësimit të kriterëve të qeseve dhe njofton AKM për marrjen e masave për ruajtjen në amjente të përcaktuara të qeseve plastike të sekuestruara si dhe e njofton atë për vendimin përfundimtar për subjektet e inspektuara.

AKM ka përsipër kryesisht të organizojë dhe zhvillojë fushata ndërgjegjësuese, të njoftojë menjëherë, nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi, subjektet e pajisura me leje mjedisore për prodhimin e qeseve plastike, të inspektojë dhe kontrollojë subjektet, të sekuestrojë dhe verë gjoba në rast të shkeljes së ligjit, të marrë masa për sigurimin e transportit dhe të ambienteve të përshtatshme për ruajtjen e përkohshme dhe magazinimin e qeseve plastike, të krijojë regjistër të dhënash lidhur me inspektimet.

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave është struktura kryesore përgjegjëse për ndalimin e importimit (çlirim për qarkullim të lirë) apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike.

Sipas një kërkesë të bërë në tetor nga Qëndresa Qytetare adresuar pranë ISHMT, rezulton se prej fillimit të implementimit të ligjit, më datë 1 qershor deri më 18 tetor të vitit 2022 (marrja e masave ndëshkuese që prej 1 korrikut), ky institucion ka kryer **2038 verifikime/inspektime/kontrolle** të subjekteve apo individëve, nga ku është vendosur vetëm 1 masë administrative me gjobë (500.000 lekë), dhe janë sekuestruar mbi 200 kg plastikë, nga ku **147.7 kg** janë sekuestruar pranë një subjekti importues.

Agjencia Kombëtare e Mjedisit i ka kryer inspektimet në terren nëpërmjet degëve të saja në 4 rajonet e Shqipërisë. Nga 12 inspektimet e kryera nga Agjencia Rajonale e Mjedisit Korçë, Elbasan dhe Berat janë vendosur 3 masa administrative me gjobë minimale, nga 500 000 (pesëqind mijë) lekë secila si dhe janë sekuestruar 480 plastikë e palejuar.

⁴Agjencia Rajonale e Mjedisit Fier, Vlorë dhe Gjirokastrë ka kryer 5 inspektime në total, nga ku të 5 subjektet prodhonin qese plastike sipas kërkesave ligjore.

⁴ [Akt bazë për përcaktimin e masave të hollësishme dhe institucioneve përgjegjëse për ndalimin e përdorimit, hedhjes në treg, prodhimin, importimit apo futjes në territorin e Republikës së Shqipërisë të qeseve plastike mbajtëse, si dhe qeseve plastike mbajtëse të oxo-degradueshme apo oxo-biodegradueshme](#)

Në Tiranë, Durrës dhe Dibër janë kryer në total 7 inspektime, ku nuk janë konstatuar parregullësi. ARM ka qenë e pranishme gjatë sekuestrimit të një sasive prej 143 kg qese të holla, të ushtruar nga ISHMT.

Në rajonin e Lezhës, Shkodrës dhe Kukësit, ARM përkatëse ka inspektuar vetëm një subjekt, i cili është i vetmi që është i pajisur me leje mjedisore për prodhimin e qeseve plastike.

Gjithsej, Agjencia Rajonale e Mjedisit ka kryer 25 inspektime, nga ku janë vendur 3 gjoba dhe ka qenë prezente në shkeljen e ligjit në një tjetër rast, të inspektuar nga ISHMT.

Pra në total, nga inspektimet e këtyre dy institucioneve rezulton se vetëm 4 subjekte në të gjithë Shqipërinë kanë shkelur ligjin qysh prej datës së fillimit të implementimit të tij.

Nxitur nga këto shifra, Qëndresa Qytetare zhvilloi një pyetësor online për të analizuar perceptimin e publikut lidhur me zbatueshmërinë e ligjit. Këtij pyetësori i janë përgjigjur 300 persona, nga të gjitha qarqet e Shqipërisë.

Perceptimi i qytetareve mbi zbatueshmërinë e ligjit për ndalimin e përdorimit të qeseve plastike një përdorimshe

Këtij pyetësori i janë përgjigjur 300 qytetarë, nga ku 78.3% e tyre i përkasin grupmoshës 15-29 vjeç, 9.7% e tyre grupmoshës 30-45 vjeç, 8% i përkasin grupmoshës 46-60 dhe 4% grupmoshës +60 vjeç.

Në këtë pyetësor janë angazhuar qytetarë nga të gjitha qarqet e Shqipërisë, sipas kësaj renditjeje: Tiranë (49.3%), Shkodër (15.3%), Elbasan (8.7%), Durrës (6.7%), Korçë (6.7%), Lezhë (3.7%), Fier (2.7%), Vlorë (2.3%), Berat (2%), Kukës (1%), Dibër (1%) dhe Gjirokastër (0.7%). 84% e të anketuarve jetojnë në zona urbane ndërsa 16% në zona rurale.

Prej këtij pyetësori, rezulton se 70% e qytetarëve të anketuar vazhdojnë të përdorin ende qese plastike.

Për 59.3% prej tyre, kostoja e blerjes së qeses së re plastike, është e lartë.

Pasi i përdorin një herë, 54.7% e qytetarëve të anketuar i ruajnë dhe i ripërdorin qeset, mirëpo 40.7% të tyre i ripërdorin vetëm për mbeturinat, 2.7% i hedhin, ndërsa 2% nuk janë të sigurt. Sakaq 53% e

të anketuarve shprehen se bëjnë blerje deri 3 herë në javë, ndërkohë që **42.33%** tregojnë se bëjnë pazare më shumë se 6 herë në javë. 74.7% e tyre, pra 224 persona, pranojnë se ka patur raste kur shitësi ju ka ofruar qese të holla një-përdorimshe, ndërkohë që 8% shprehen jo të sigurtë.

Nga ana tjetër 67% e tyre shprehen se kjo gjë u ka ndodhur pas qershorit. **Pra 201 persona nga 300 konfirmojnë se janë ndeshur me shkelje të këtij ligji.** Ndërkohë pjesa më e madhe e të anketuarve që dëshmojnë këtë gjë, banojnë aktualisht në Tiranë.

94% prej tyre kanë degjuar për ligjin për ndalimin e përdorimit të qeseve plastike, ndërsa 4.3% jo dhe 1.7% shprehen se nuk e dinë.

Për këtë ligj, qytetarët janë informuar më së shumti nga televizioni (35.3%), më pas lajmet (28.3%), media sociale (29%), miqtë (6%).

68.33% qytetarëve të anketuar nga të gjitha qarqet, ende vazhdojnë të përdorin qeset plastike kur kryejnë blerje.

Fushata sensibilizuese lidhur me ligjin

Për të informuar e sensibilizuar qytetarët, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, i ka nisur publikimet në platformën sociale Facebook, vetëm 13 ditë përpara fillimit të zbatimit të ligjit, duke mos bashkangjitur me link asnjë informacion më të detajuar lidhur me këtë ligj.⁵

Sakaq, më datë 1 qershor dhe vetëm në këtë datë, në faqen e Ministrisë, publikohen punonjësit e AKM në terren pranë disa njësive tregtare.

Ndërsa AKT përpara datës 1 qershor ka përdor vetëm opsionin e rishpërndarjes të disa publikimeve nga Ministria dhe ka publikuar momente nga ndërgjegjesimi në publik kryesisht me njësitë tregtuese dhe disa shkolla/gjimnaze. AKT duket se ka kryer vazhdimisht takime ne qytete te ndryshme. Megjithatë ky insitucion përgjegjes për ndërgjegjësimin e qytetarëve lidhur me ligjin, nuk ka zhvilluar një fushatë sensibilizimi të tijin në platformat sociale që targeton audiencën online.

Ndërkohë vihet re një ndërpreje e publikimeve lidhur me këtë ligj nga data 12 gusht deri me 28 shtator pushim, pra 1 muaj e gjysmë shkëputje.

Përgjithësisht në publikimet e këtyre të fundit, ana përmbajtësore nxit audiencën për përdorimin e cantave mbajtëse disa-përdorishme por sipas perceptimit të qytetarëve kjo nuk është e mjaftueshme.

Një pjesë e madhe prej tyre ende vazhdon ti përdorë qeset plastike.

⁵ [Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ambasada Britanike nisin fushatën "Unë dhe Ti për Mjedisin"- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit](#)

Gjetjet kryesore

- Shqipëria është një nga ndotësit më të mëdhenj në botë të oqeaneve, duke kontribuar me mesatarisht 0.54 kg plastikë për person, vetëm për vitin 2019.
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit ka nisur fushatën e sensibilizimit mbi ligjin vetëm 2 javë përpara implementit dhe në asnjë publikim nuk ka bashkangjitur link për informacion më të detajuar me ligjin.
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit, si insitucioni përgjegjës për fushatat sensibilizuese, ka arritur të bëjë disa takime fizike pranë bizneseve dhe shkollave, por nuk ka ndërmarrë asnjë fushatë online dhe të bëjë publikime konstante për edukimin e audiencës online.
- ISHMT ka kontrolluar 2038 individ/subjekte dhe AKM 25 të fillë, ku në total janë konstatuar 4 raste të shkeljes së ligjit, shifër shumë e ulët në krahasim me ekperiencat e lidhura të qytetarëve pas datës 1 qershor 2022.
- **Në një anketim të kryer nga Qëndresa Qytetare, 201 persona nga 300 konfirmojnë se janë ndeshur me shkelje të këtij ligji, ku më kontretisht shitësi u ka ofruar qese plastike një-përdorimshme, pas 1 qershorit të këtij viti.** Ndërkohë pjesa më e madhe e të anketuarve që dëshmojnë këtë gjë, banojnë aktualisht në Tiranë.

Rekomandime

- Problemi i ndotjes nga plastika nuk lidhet vetëm me plastikën por edhe me mungesën e kulturës së shoqërisë shqiptare lidhur me mbrojtjen e mjedisit, prandaj duhet parë primare investimi në edukimin e një kulture të re.
- Për të ulur ndotjen nga plastika, duhet të krijohet infrastruktura e posame sikurse koshat me ndarje të mbetjeve, të cilët duhet të jenë të aksesueshëm kudo, nga të gjithë.
- Ministria e Turizmit përvecse uljes së përdorimit të qeseve plastike, duhet të ndërgjegjesojë edhe mbi uljen e përdorimit të plastikës po ashtu dhe ti kushtojë një rëndësi më të vecantë edukimit mbi 3R-të e mjedisit. (Reduktim, Ripërdorim dhe Riciklim). Riciklimi i plastikës duhet parë si hallka e fundit, ndërkohë që fare mirë qytetarët mund të edukohen se si të minimizojnë përdorimin e plastikës si dhe në rast përdorimi, si ta ripërdorin disa herë në mënyra të dobishme atë.
- Mbrojtja e mjedisit nga ndotja nuk kufizohet vetëm me uljen e përdorimit të qeseve plastike një-përdorimshme, por të plastikës në tërësi, prandaj Ministria duhet ta përfshijë këtë aspekt në fushatat e saj. Për një ndryshim të qëndrueshëm, Ministria duhet të vazhdojë fushatat ndërgjegjesuese në mënyrë të qëndrueshme.
- Agjencia Kombëtare e Mjedisit, si insitucioni përgjegjës për fushatat sensibilizuese, duhet të përdorë më aktivisht prezencën e saj në platforma sociale, duke mos dëshmuar vetëm aktivitetet e realizuara, por edhe të edukojë audiencën e saj.

#QËNDRESË / MIRËQEVERISJE

QENDRESA
QYTETARE



NATIONAL
ENDOWMENT
FOR
DEMOCRACY

SUPPORTING FREEDOM AROUND THE WORLD

www.qeverisja.qq.com.al